



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300807/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Gramsh.

Drejtuar: Z. Ilir PRODA
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan

ELBASAN

Z. Krenar GUÇE
Shef i Komisariatit të Policisë Gramsh

GRAMSH

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisaratin e Policisë Gramsh.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 të ligjit nr.81 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Gramsh.

Inspektimi u krye në datën 14.09.2023, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi

dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, të referuara në vijim:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit z. Krenar Guçe dhe shefin e Seksionit për Hetimin e Krimeve në Volum z. Lulëzim Preçi të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Guçe informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit referuar inspektimit të mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisaritati sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi inspektimin në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar të arrestuar apo ndaluar.

Drejtuesi dhe punonjësit në Komisariatin e Policisë Gramsh, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë gjithë inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij Komisaritati.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se¹:

1. **Ishte zbatuar rekomandimi** mbi eliminimin e lagështirës që ishte prezent në dhomat për të shoqëruarit gra dhe të mitur si dhe korridorin e ambientit të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Gramsh.
2. **Ishte zbatuar rekomandimi** mbi marrjen e masave për plotësimin në mënyrë korrekte dhe me përgjegjësi të “Regjistrin të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” sipas tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

¹ Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Gramsh Nr.K4/I40-2Prot Dt.07.09.2022.

3. **Ishte zbatuar rekomandimi** mbi marrjen e masave nga ana e punonjësve të policisë për plotësimin në mënyrë korrekte dhe me përgjegjësi rubrikën e njoftimit të familjarëve në kohën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë, nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

1. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi** mbi marrjen e menjëhershme të masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe në dhomën për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar në mjediset e këtij Komisariati.
2. **Nuk ishin marrë masat të nevojshme**, për dhënien e kartës së të drejtave në momentin në të cilin palët hyjnë në komisariat.
3. **Nuk ishin marrë masat të nevojshme** për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

Në përfundim, grupi inspektimit konstatoi se, megjithëse në Komisaratin e Policisë Gramsh ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me kushtet materiale dhe të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, që i gjeni si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisaratin e Policisë Gramsh, ambientet e shoqërimit ndodheshin në katin e parë të godinës të komisarimit. Ky mjedis përbëhej nga 3 (tre) dhoma shoqërimi për mbajtjen dhe trajtimin e personave të shoqëruar, nga të cilat 1 (një) dhomë për burra, 1 (një) për gra dhe 1 (një) për të miturit.

Sipërfaqja dhe hapësira e dhomave të shoqërimit ishin të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, të pajisura me orëditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, me kushte për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që ligji iu njeh këtyre personave. Kapaciteti total i dhomave të shoqërimit ishte për 9 persona.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Të treja dhomat e shoqërimit ishin të lyera, të pastra nga ana higjieno sanitare. Për përmirësimin e kushteve dhe eliminimin e lagështirës në dhomat e shoqërimit kishte ndikuar edhe hidroizolimi i tarracës.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej vetëm një tualet i cili përdorej nga gratë dhe të miturit i pajisur me çezmë dhe kishte ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje, ndërkohë që të shoqëruarit burra i dërgonin në tualetin e katit të dytë i cili ishte rikonstruktuar së fundmi në institucion. Tualetet i plotësonin kushtet higjieno sanitare, ishin të lyera dhe të dezinfektuara.

Në ambientin e shoqërimit kishte një zyrë pune për specialistët dhe ndihmës specialistët e policisë, e cila duhet të shërbente si dhomë për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar në mjediset e këtij Komisariati. Përgjatë inspektimit konstatuam se personat e shoqëruar në mjediset e policisë, vijonin të intervistoheshin në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në zyrën e intervistimit. Zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave për të vëzhguar veprimet procedurale që kryejnë me personat e shoqëruar.

Grupi i inspektimit konstatoi se *mungonte sistemi i monitorimi me kamera* për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit, si dhe zyrës ku merren në pyetje personat e shoqëruar. Në këtë Komisariat kishte gjithsej tre kamera të cilat duhet të monitoronin ambientet e tij, por edhe këto kamera ishin jo funksionale. Në vijim të rekomandimit tonë, drejtuesi i Komisariatit Gramsh me shkresën nr. 1127 prot., datë 26.08.2022 “*Kërkesë për plotësimin e disa mungesave në drejtim të Sektorit Logjistik*”, drejtuar Drejtorit të Policisë Vendore Elbasan ndër të tjera ka kërkuar vendosjen e kamerave në ambientet e shoqërimit të Komisariatit.

Mungesa e sistemit të monitorimit me kamera, kryesisht në dhomën për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, mund të përbëjë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, si dhe për respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave. Mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjedisëve në komisariate, përveç atyre mjedisëve ku cenohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të shoqëruarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Së dyti, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisariateve, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që hartohen nga institucionet monitoruese të pavarura.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë Komisariat zbatoheshin detyrimet ligjore të parashikuara në nenet 109 paragrafi 5² dhe 122 paragrafi 5³ e ligjit nr. 108/2014 “Për

² Neni 129 paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar parashikon se: “Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.”

³Neni 122 paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar parashikon se: “Veprimet e mësipërme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në këtë dispozitë, dokumentohen në procesverbal. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet

Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Kapitullin VIII, pika a.3.4⁴ të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Në Komisariatin e Policisë Gramsh, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 14.09.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit 121 persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112 paragrafi 1 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar. Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë shtetas në dhomat e shoqërimit.

Gjithashtu, na informuan se personat e shoqëruar nga policia janë informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/ procedurale që ata kanë, por konstatuam se mungonte karta e të drejtave e printuar për t’u pajisur personat e shoqëruar e për t’u njohur me të drejtat e tyre në orët e para të shoqërimit në ambientet e komisariatit të policisë. Mekanizmi Kombëtar kërkon dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore që në momentin e hyrjes në Komisarimat⁵.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Gramsh nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Elbasan. Së fundmi, për shkak të rikonstruksionit të Komisariatit të Policisë Elbasan, personat e ndaluar/arrestuar dërgoheshin në Bllokun e Sigurisë në Tiranë.

Regjistri i personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin Gramsh, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte plotësuar në zbatim të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, sipas tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde

dhe personi/at që kanë qenë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit, ndaj të cilit janë marrë masat mbrojtëse, ose familjarit/kujdestarit të tij.”

⁴ Urdhër, nr. 938 datë 24.07.2019 “Procedura standarde e punës për: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit” a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: a.3.4 “Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimit personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.”

⁵ CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici).

Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t’u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t’u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit.

Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>

“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.938 datë 24.07.2019 e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Personat e shoqëruar në mjediset e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezulton se koha e qëndrimit në gjendjen e shoqërimit të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri 10 orë në raste të veçanta.

Në këtë Komisarariat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën në momentin e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Gjithashtu, në këtë Komisarariat administrohej regjistri për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, megjithatë u konstatua se rubrikat e regjistrit **nuk ishin plotësuar** në mënyrë korrekte.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 “Kërkesë/ankesat e të shoqëruarve, të ndaluarve dhe të arrestuarve” të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Ambientet e intervistimit

Në Komisariatin e Policisë Gramsh punonjësit e policisë i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës ndonëse edhe nga inspektimet e mëparshme në këtë komisarariat kemi konstatuar se ishte përshtatur një zyrë për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Kjo zyrë dhe ambientet e komisarariatit, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga punonjësit e policisë. Nga biseda me drejtuesit na u bë me dije se kjo zyrë nuk përdorej nga punonjësit për shkak të mungesës së bazës materiale e cila shërben për marrjen në pyetje të të shoqëruarit si kompjuter, internet etj.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në veçanti në këto zyra dhe ambientet e shoqërimit, por është konstatuar se ky rekomandim nuk është plotësuar.

Avokati i Popullit, referuar standardeve ndërkombëtare⁶ e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Nga monitorimi që iu bë zyrave të punonjësve të policisë, por edhe zyrës së intervistimit nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë, rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit në moshë madhore, të cilët nuk kishin mundësi financiare për të marrë avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin për në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, për kryerjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit për të miturit dhe në praninë e detyrueshme të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë Elbasan, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me Bashkinë e Gramshit.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin e godinës dhe brenda dhomave të shoqërimit ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarjat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

⁶ “*Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.*” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

Konsulto:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe në dhomën për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar në mjediset e këtij Komisariati.
2. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
3. Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin e punonjësve të ngarkuar me detyrën për plotësimin me korrektësi të të gjitha rubrikave të regjistrit të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar të mitur (14-18 vjeç).
4. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave në momentin në të cilin personat e shoqëruar hyjnë në komisariat.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

AHMET PRENÇI

Konc.& Dakord.:
G.Çarkaxhiu